



BASHKIA ROSKOVEC

BASHKIA ROSKOVEC NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD2 SHPALL:

THIRRJEN PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE FINANCUAR NGA BASHKIA ROSKOVEC ME ASISTENCËN TEKNIKE TË PROGRAMIT RAJONAL PËR DEMOKRACINË VENDORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR 2 (ReLOaD2)

Bashkia ROSKOVEC vlerëson punën e Organizatave të Shoqërisë Civile në mbështetje të arritjes së Prioriteteve të Bashkisë dhe e konsideron të rëndësishëm bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe konkret me këto organizata për realizimin e objektivave programorë të saj.

Prandaj, Bashkia ROSKOVEC shpall thirrjen publike për paraqitjen e Projekt Propozimeve nga organizatat e Shoqërisë Civile me fonde të financuara nga buxheti i Bashkisë i Vitit 2024.

Pas eksperiencës së fituar gjatë zbatimit me sukses të metodologjisë LOD dhe sipas memorandumit të mirëkuptimit të lidhur mes Bashkisë Roskovec dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD), në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2), Bashkia garanton një proces të hapur dhe transparent aplikimi dhe vlerësimi të projekt propozimeve.

Për sa më sipër, Bashkia **Roskovec** fton të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me prioritetet dhe objektivat zhvillimore të Bashkisë, si më poshtë:

Prioriteti 1

Fuqizimi i Rinisë për të qenë qytetar aktiv:

1.1 Hartimi i planit të veprimit për rininë dhe pilotimi i një prej objektivave të tij

Prioriteti 2

Zhvillim i qëndrueshëm i turizmit:

2.1 Hartimi I strategjise se Turizmit dhe implementimi i një prej objektivave të tij
Shuma e fondeve për projektet e miratuara do të jetë:

Shuma 500.000 lekë

Bashkia Roskovec rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Kohëzgjatja e secilit projekt duhet të zgjasë 6 muaj.

Projektet e përzgjedhura do të zbatohen në periudhën nga muaji Dhjetor 2024 –Maj 2025.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht në përputhje me ligjin “Për Organizatat Jo-fitimrurëse” në Shqipëri.

Të gjitha organizatat e shoqërisë civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë (Shtojca 6), pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.

DOKUMENTACIONI:

Dokumentacioni i aplikimit për thirrjen publike të **Bashkisë Roskovec** mund të tërhiqet, pas dërgimit të një kërkesë me e-mail në adresën info@bashkiaroskovec.gov.al, enirjeta.shehu@bashkiaroskovec.gov.al ku duhet të citoni emrin e organizatës së interesuar; ose duke u paraqitur personalisht në adresën:

**Bashkia Roskovec
Zyra e Njësisë së Integritimit
Lagja nr 1, Roskovec**

Të gjitha informacionet e nevojshme, si dhe një version elektronik i paketës së aplikimit mund të gjendet edhe në website zyrtare të Bashkisë: www.bashkiaroskovec.gov.al

SESIONET INFORMUESE (ditët e hapura për më shumë informacion)

Lidhur me këtë thirrje, për OShC-të e interesuara për të aplikuar në këtë thirrje do të mbahen Sesione informuese në Bashkinë Roskovec me datën 25.10.2024 në orën 11:00 në zyrat e Bashkisë.

Më shumë informacione për këtë aktivitet do të jepen së shpejti nga Bashkia Roskovec nëpërmjet website/mediave sociale.

Pyetje rreth kësaj thirrje mund të behën përmes adresës , enirjeta.shehu@bashkiaroskovec.gov.al

Kërkesat mund të dërgohen deri një javë përpara mbylljes së thirrjes dhe përgjigjet në pyetjet e parashtruara do të dërgohen me shkrim brenda 5 ditëve pas pranimit të kërkesës. Për qëllime transparence, përgjigjet do t'u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm.

DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në tre (3) kopje fizike dhe një kopje elektronike (USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte), nga ora 09:00 deri ora 15:00, në adresat në vijim:

Bashkia Roskovec
Lagja nr 1, Qendër Roskovec

Afati për dorëzimin e aplikimeve është data **15.11.2024, ora 16:00**. Aplikimet e dorëzuara në bashki pas këtij afati do të merren parasysh vetëm nëse vula postare tregon se data dhe koha e dërgimit ka qenë para mbylljes së afatit zyrtar. Pjesa e jashtme e zarfit duhet të përmbajë titullin e thirrjes për dorëzimin e propozimeve, emrin dhe adresën e plotë të kandidatit, emrin e plotë të projektit dhe mbishkrimin **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare.”**

Formulari për regjistrimin e dokumentacionit të pranuar lëshohet nga përfaqësuesi i bashkisë.

Të gjithë aplikantët që kanë paraqitur propozime, pavarësisht nëse pranohen ose jo, njoftohen me shkrim për vendimin e marrë për projekt-propozimin e tyre brenda **15 ditëve** nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet do të publikohen në faqen e internetit të bashkisë, në tabelën e njoftimeve të bashkisë Roskovec.